



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE, LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 253 Prot.

Tiranë, më 27 / 06/ 2012

Lënda: Rekomandime për grupin ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Drejtuar: Znj. Nora MALAJ
ZV/MINISTËR
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

TIRANË

E nderuar znj. Malaj,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në urdhrin e Kryeministrit, nr. 52, datë 23. 04. 2012 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02, 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ka ndjekur mbledhjet e grupit të punës të ngritur në zbatim të këtij urdhri. Rekomandimet tona të cilat janë përcjellë edhe gjatë mbledhjeve të zhvilluara nga grupi i punës, konsistojnë sa më poshtë:

Akti nënligjor që kërkohet në nxirret në zbatim të detyrimit që buron nga neni 39 i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", duhet të adresojë parashikimet që bëhen në nenin 18 të këtij ligji. Për këtë arsye, akti duhet të rregullojë përgjegjësitë që ky nen i ligjit i ka ngarkuar Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të marrë



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431077
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

masa me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsim. Konkretisht, masat që ndër të tjera, duhet të parashikohen në këtë akt nënligjor janë:

I. ndërmarrja e një fushatë kombëtare për ndërgjegjësimin e gjithë sistemit arsimor për ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Gjatë dy projekteve të realizuara nga ana jonë me mbështetjen e UNICEF Albania, me fokus sistemin arsimor, një për sensibilizimin dhe edukimin në lidhje me ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* dhe funksionet e Zyrës, Komisioneri me temë *“Zbatimi i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi në sistemin arsimor”* dhe monitorimit *me fokus sjelljet diskriminuese ne sistemin arsimor dhe niveli i njohjes se ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, realizuar në bashkitë* Shkodër, Tirane, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe u shtri ne 6 shkolla për secilën bashki, u konstatua një nivel shumë i ulët ndërgjegjësimi.

II. ndërhyrja në kurrikulat e sistemit arsimor, në mënyrë që të futen në programet arsimore konceptet e diskriminimit, format e shfaqjes së tij si dhe të gjejnë pasqyrim veprimet kundër modeleve të sjelljeve diskriminuese.

III. detyrimi i drejtuesve të institucioneve arsimore që të parashikojnë rregulla dhe procedura të qarta për trajtimin e ankesave për diskriminimin që u paraqitën.

IV. detyrimi i drejtuesve të institucioneve publike dhe private për të marrë të gjitha masat e nevojshme që të krijojnë kushtet e përshtatshme dhe mbështetëse efektive në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar.

V. që në statistikat zyrtare që mban Ministria e Arsimit dhe Shkencës të përfshijë të dhëna të zbërthyerja sipas grupeve të aftësisë së kufizuar, apo shkaqeve të tjera të parashikuara nga ligji *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* dhe konsiderohen si grupe që janë ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit. Mbajtja e të dhënave të sakta do të shërbejë për të adresuar marrjen e masave me karakter pozitiv dhe zgjidhjen e problemeve që ndeshën këto kategori.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431077
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

- VI. zyrtarizimi i gjuhës shqipe të shenjave për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe dëgjim, për të siguruar në këtë mënyrë të drejtën për arsim në mënyrë të përshtatshme. Situata aktuale e kësaj kategorie të aftësisë së kufizuar kërkon një ndërhyrje emergjente, për shkak se mungesa e gjuhës shqipe të shenjave i përjashton këta persona nga pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konc: K.Kamberaj, Specialiste në DÇPLMJ,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431077
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al